

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

[Data 24.07.2026]

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) X

OE "TETRA" shpk NIPT K72017027P, me adresë: TIRANE Rruga "Gjin Bue Shpata", Pallati 2/1, Ap.2, Njesia Bashkiake Nr.5

ose

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____
(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat:

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur mbi kufirin e larte monetar,

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: : **REF- 89136-06-08-2026**

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Ndërtimi i nyjeve multimodale të mobilitetit, Rajoni 3&4: Permiresimi I performances se parkimeve permes plotesimit me pajisje teknologjike"

Fondi limit: 94,620,680.51 Lek pa TVSH. Financimi i këtij objekti është parashikuar në programet buxhetore për periudhën 2026-2028 në kuadër të programit GOA, me kod projekti 25AA502. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 990,792.46 Euro.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 6 muaj

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 09.06.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike Data 15.06.2026 Numri 39

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. OE "TETRA" shpk NIPT K72017027P, vlera 89.950.000 lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit

2. OE 2 N shpk NIPT L31615017L, vlera 80.000.000 lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit

* * *

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar, Ofertuesi i mëposhtëm:

1. OE 2 N shpk NIPT L31615017L, vlera 80.000.000 lekë pa tvsh, Skualifikohet per arsye se Operatori Ekonomik “2 N” sh.p.k. nuk përmbush kriterin për kapacitetin teknik, të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Kriterëve të Veçanta të Dokumenteve Standarde të Tenderit, lidhur me përvojën e suksesshme në realizimin e furnizimeve të ngjashme për objektin e prokurimit: “Ndërtimi i nyjeve multimodale të mobilitetit, Rajoni 3 & 4: Përmirësimi i performancës së parkimeve përmes plotësimit me pajisje teknologjike.” Sipas pikës 2.3.1 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës. Këto furnizime duhet të provohen si më poshtë: a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara pranë organeve tatimore, ku të pasqyrohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara pranë organeve tatimore, ku të pasqyrohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se operatori ekonomik nuk ka arritur të provojë përmbushjen e kriterit të përvojës së ngjashme, pasi kontratat e paraqitura në funksion të këtij kriteri nuk kanë objekt të ngjashëm me objektin e procedurës së prokurimit. Konkretisht janë paraqitur kontratat:

- 1_P_N_B_Belsh__Sist_Asfa_Rruga_Belsh_Stanaj_18_996_834_52;
- 2_P_N_B_Belsh_Rikon__i_Rrugës_Rrasë_Pajalli_19_370_363_6;
- 4_P_N_B_Kamëz__Ndërtim_Rrugët_Josif_Mihali_etj__37_593_535_83;
- 5_P_N_B_Kamëz_Ndërtim_Rrugët__Lidhja_e_Prizrenit_etj__28_260_528_33;
- 6_P_N_B_Lushnje__Urbanizimi_i_Bllokut_Savër_25_000_000;
- 7_P_N_B_Dibër__Rruga_në_Fshatin_Lishan__14_621_057;
- 8_P_N_B_Kurbin__Asfaltim_Rruga_Artan_Farka_7_646_300;
- 9_P_N_B_Kurbin__Asfaltim_Rruga_Kampi_7_600_050;
- 10_P_N_DPASH_Arkivi_Shkozë_36_188_600.

Nga analiza e objekteve të këtyre kontratave rezulton se ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin, rikonstruksionin, urbanizimin dhe asfaltimin e rrugëve, si dhe me punime ndërtimore të infrastrukturës civile. Këto kontrata nuk kanë si objekt furnizimin dhe instalimin e pajisjeve teknologjike për menaxhimin e parkimeve apo sistemeve të mobilitetit, të cilat përbëjnë thelbin e

objektit të kësaj procedure prokurimi. Për rrjedhojë, kontratat e paraqitura nuk provojnë përvojë të ngjashme në kuptim të pikës 2.3.1 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, pasi nuk paraqesin përputhshmëri me objektin e prokurimit për sa i përket natyrës së furnizimeve, karakteristikave teknike, kompleksitetit të realizimit dhe teknologjisë së përdorur. Si pasojë, operatori ekonomik nuk arrin të provojë përmbushjen e kriterit të përvojës së ngjashme, pavarësisht vlerës së kontratave të paraqitura, pasi kërkesa e autoritetit kontraktor lidhet jo vetëm me vlerën ekonomike të kontratave, por edhe me ngjashmërinë e tyre me objektin e prokurimit. Për këtë arsye, dokumentacioni i paraqitur nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.1 të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se operatori ekonomik “2 N” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 të Kriterëve të Veçanta të Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe, për rrjedhojë, oferta e tij skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE "TETRA" shpk NIPT K72017027P, me adresë: TIRANE Rruga "Gjin Bue Shpata" ,Pallati 2/1, Ap.2,Njesia Bashkiake Nr.5, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 89.950.000 (*tetëdhjetë e nente milion e nenteqind e pesëdhjetë mijë*) lekë pa tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

DREJTOR EKZEKUTIV

DRITAN AGOLLI